

Tri janë parashtesat e gjuhës shqipe me të cilat fjalëve u jepet kuptim mohor: pa, mos dhe jo, p.sh.: i padrejtë, padrejtësi, mosveprim, jozyrtar.

Ndonëse që të gjitha kuptim mohor u japin fjalëve, nuk bën të përdoren në vend të njëra-tjetrës, pra ka rregulla që përcaktojnë prej cilave fjalë formohen fjalët me kuptim mohor të tyre me këtë parashtesë dhe prej cilave me atë parashtesë.

Për shqipen, duhet ta dinë të paktën njerëzit që pretendojnë se po merren me shkencë e me kulturë, ka mbaruar koha kur zhvillimet e vetvetishme luanin rol përcaktues për përdorimin e një trajte a të një tjetre të një fjale. Sot, kur duam të gjykojmë trajtat e fjalëve shqipe cila është e drejtë të përdoret, nuk i vështrojmë cila ka përdorim më të shumtë, por cila është normative.

Kështu duhet të veprojmë edhe me fjalët që përdoren kryesisht vetëm në ligjërimin e shkrimit për fe. Fjalët e këtilla, asnjëherë nuk janë sjellë si shembuj për rregullat në librat normativë të shqipes standarde për arsye të ditura ideologjike që vepronin në kohën kur u hartuan këto rregulla. Kjo është vetëm njëra vështirësi, karakteristikja, që paraqitet lidhur me fjalët që kanë të bëjnë me fenë, kurse vështirësia tjetër vlen si për to ashtu edhe për krejt shqipen: nuk ka referencë të plotë gramatikore së cilës të interesuarit me lehtësi mund t'i ktheheshin për t'u shpjeguar lidhur me rregullat përkatëse për çështjet gramatikore a të fjalëformimit që u interesojnë.

T'u kthehemi fjalëve të shkruara në titull: pabesimtar, mosbesimtar dhe jobesimtar.

Sa kam parë unë dhe sa kam pyetur lexues (kryesisht hoxhallarë) më së shumti në shkrimet dhe ligjëratat fetare përdoret fjala 'pabesimtar', kurse normative nga këto tri fjalë është vetëm fjala 'jobesimtar'.

Pse vetëm fjala 'jobesimtar' është normative?

Sipas rregullave të shqipes standarde, me parashtesën 'pa' formohen fjalë prej emrave abstraktë p.sh.: drejtësi-padrejtësi, dhe prej mbiemrave të nyjshëm, p.sh.: i drejtë- i padrejtë.

Me parashtesën 'mos' formohen fjalë prej emrave prejfoljorë që mbarojnë me 'im' ose 'je', p.sh.: veprim-mosveprim, paraqitje-mosparaqitje. Kurse me parashtesën 'jo' formohen fjalë prej mbiemrave të panyjshëm, p.sh.: zyrtar-jozyrtar, përparimtar-jopërparimtar.

Fjala 'besimtar' është mbiemër i panyjshëm, prandaj mbiemri me kuptim mohor të tij, sipas rregullave të sipërshkruara, duhet të formohet me parashtesën 'jo'. Nuk mund të formohet me parashtesën 'pa', sepse as nuk është emër, as nuk është mbiemër i nyjshëm, dhe nuk mund të formohet me parashtesën 'mos', sepse nuk është emër prejfoljor që mbaron me 'im' ose 'je'.

U bie të përdoren shpesh dhe janë fjalë kyçe, në ligjërimin dhe në shkrimin për fenë, shumë fjalë me kuptim mohor të ndërtuara me parashtesat 'mos', 'pa' dhe 'jo', dhe një pjesë e madhe e tyre zakonisht po përdoren gabim, prandaj, sa herë të kemi të bëjmë me fjalë të tilla, ia vlen t'i

rikujtojmë rregullat që u sollën këtu që të sigurohemi se, të paktën fjalët kyçe të ligjërimeve dhe të shkrimeve tona, i përdorim drejt.

Ilmi Rexhepi